



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 janar 2013  
Nr. ref.: RK371/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI123/12**

Parashtrues

**Bajrush Gashi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,  
Pzd. Nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Kërkesa**

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Bajrush Gashi, me banim në fshatin Hoqë e Vogël, Komuna e Rahovecit (parashtrues i kërkesës).
2. Më 27 janar 2012, parashtruesi parashtrroi kërkesën e parë (Rasti Nr. KIO6/12) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
3. Më 9 maj 2012, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme, si dhe gjeti shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## Objekti i çështjes

4. Kjo kërkesë është në vazhdimësi të Rastit Nr. KIO6/12. Parashtruesi i kërkesës tash ankohet se:

“ ...  
a. Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren ka qenë jotransparent, pa fakte e argumente.  
b. Prokurori i rastit, derisa merrte në pyetje dëshmitarin kryesor të këtij rasti, e ka përjashtuar atë nga zyra e tij, duke e kërcënuar që nëse nuk bashkëpunon, do ta dërgojë në burg.  
c. Kërkesa ime dhe kërkesa e mbrojtjes sime ishte që V. E. të merret në pyetje si dëshmitar. Prokurori dhe Gjyqtari V. D. kanë refuzuar këtë.  
d. Gjyqtari V. D., në gjykatën e shkallës së parë ishte Kryetar i Kolegjit, si dhe anëtar i Kolegjit në Gjykatën Supreme. Gjyqtari V. D. ka marrë pjesë drejtpërdrejt dhe indirekt në gjitha ankesat e mia, vetëm për të mbrojtur vendimin jo-transparent të Gjykatës së Qarkut.  
e. Kam parashtruar ankesë për këtë në Gjykatën Kushtetuese, dhe më keni dhënë këtë të drejtë, si dhe e keni kthyer për rishqyrtim.  
f. Gjykata Supreme ka ndërruar vetëm kolegjin, si dhe ka vendosur njëjtë si më parë.  
...”.

5. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

## Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

## Procedura në Gjykatë

7. Më 9 maj 2012, Gjykata Kushtetuese, në rastin e mëparshëm Nr. KIO6/12, e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, me bazën që “[...] në rrethanat e rastit, paanshmëria e Gjykatës Supreme ka mundësi të jetë e hapur për dyshim, si dhe frika e parashtruesit në këtë kuptim mund të konsiderohet subjektivisht dhe objektivisht e arsyetuar”, sepse “[...] i njëjti gjyqtar që kryesonte kolegjin në Gjykatën e Qarkut në Prizren, gjithashtu mori pjesë në Kolegjin e Gjykatës Supreme, duke vendosur mbi kërkesën e tij për zbutje të dënimit”.
8. Pastaj, Gjykata Kushtetuese “SHPALLI të pavlefshëm Vendimin Pzd. Nr. 67/2011 të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2011, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së”, si dhe “I KTHEU Vendimin Pzd. Nr. 67/2011, të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2011, Gjykatës Supreme për rishqyrtim, në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate, në bazë të rregullit 74.1 të Rregullores së punës”.
9. Më 17 tetor 2012, Gjykata Supreme e njoftoi Gjykatën Kushtetuese që e ka rishqyrtuar vendimin e saj në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, pra duke marrë vendim me një përbërje tjetër të gjyqtarëve (Vendimi Pzd. Nr. 65/2012, i 10 shtatorit 2012).

10. Më 4 dhjetor 2012, parashtruesi parashtroi një kërkesë të re në Gjykatë.
11. Më 10 janar 2013, Kryetari i Gjykatës emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe emëroi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
12. Më 29 janar 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmëri të kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Asnjë informatë e re përkitazi me rastin e mëparshëm KIO6/12 nuk i është paraqitur Gjykatës.
14. Faktet, ashtu siç përshkruhen në rastin KIO6/12, janë të përmbledhura si në vijim:
15. Më 19 maj 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren shpalli parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 138.6, në lidhje me nenin 138.1 dhe me nenin 328.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), si dhe e dënoi atë me 4 vjet e 4 muaj burgim (Aktgjykimi P. Nr. 26/09). Parashtruesi u ankua ndaj këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme. Prokurori publik, gjithashtu, u ankua ndaj këtij aktgjykimi për sa i përket pjesës që kishte të bënte me të bashkëpandehurin G. M.
16. Më 8 dhjetor 2010, Gjykata Supreme hodhi poshtë, si të pabaza, ankesat e parashtruesit dhe të Prokurorit Publik, si dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (Aktgjykimi Ap. Nr. 259/2009).
17. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata Supreme hodhi poshtë, si të pabazë, kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (Aktgjykimi Pzd. Nr. 67/2011).
18. Në këtë kuptim, parashtruesi pretendoi para Gjykatës Kushtetuese që gjyqtari që ishte kryesues i Kolegjit në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe kishte vendosur rastin e tij, gjithashtu kishte marrë pjesë në vendimin e Gjykatës Supreme për kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (gjyqtari në fjalë).
19. Për më tepër, parashtruesi pretendoi që gjyqtari në fjalë duhej të informonte Gjykatën Supreme se ai kishte qenë kryesues Kolegji në Gjykatën e Qarkut në Prizren, si dhe duhej përjashtuar nga pjesëmarrja në Kolegjin e Gjykatës Supreme.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

20. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet Rregullit 36.3.e, i cili përcakton: *“Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: (e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”*.
22. Ankesa e parashtruesit përkitazi me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, tashmë është trajtuar nga Gjykata me Aktgjykimin e saj në Rastin Nr. KIO6/12.

23. Parashtruesi nuk ka ofruar fakte të reja, e as baza të mjaftueshme për vendim të ri.
24. Për më tepër, Gjykata Supreme tashmë ka njoftuar Gjykatën Kushtetuese që ka vepruar në përputhje me Aktgjykimin kushtetues (*Shih Aktvendimin Pzd. Nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012*).
25. Kështu, në bazë të rregullit 36.3.e të Rregullores, Gjykata nuk do të merret me këtë kërkesë të re.
26. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se kërkesa, në bazë të rregullit 36.3.e të Rregullores së punës, është e papranueshme pasi Gjykata tashmë ka vendosur për çështjen në fjalë.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 36.3.e dhe të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, më 29 janar 2013, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme, pasi Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për rastin e parashtruesit të kërkesës në Rastin Nr. KIO6/12, do të thotë rasti është *res judicata*;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve; dhe
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani